



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Sh.II.nr.1067/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Krenar Berisha dhe Faton Bajrami, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NT “Fetaj” me seli në Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokati P.P., kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1080/19 të datës 15.02.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.02.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit NT “Fetaj” me seli në Gjakovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1080/19, të datës 15.02.2022, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.1080/19, të datës 15.02.2022, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit NT “Fetaj” me seli në Gjakovë, ndërsa mbetet në fuqi vendimi nr.58/2019, i datës 04.04.2019, i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të LPA, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar, ose lëndën ta kthej në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat

nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës, me vendimin nr.58/2019, të datës 04.04.2019, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën nr.58/2019 të tatimpaguesit NT “Fetaj” me NRB:80065396 dhe NRF 600292726, me pronar H.F., me seli të biznesit adresa Fshati Hereq – Gjakovë, në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në lidhje me nenin 89, paragrafin 2, të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Njoftim Rivlerësimi i tatimit shtesë dhe ndëshkimet e caktuara me kontroll, konfirmohen si të bazuara.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 08.05.2019, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit nr.58/2019, të datës 04.04.2019, të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilën kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të kontestuar ka theksuar se Gjykata ka shqyrtuar pretendimet dhe provat e bashkangjitura padisë së paditësit, dhe ka konstatuar se ne baze të transaksionit bankar të dt. 16.05.2018 përmes bankës private të Biznesit në vlerë prej 16.500€ potencohet pagesa për cisterne dhe traktor kuponi 035489, ky transaksion bankar sipas pas verifikimi e paditura vërtetohet se transaksioni bankar është në mes të subjektit “Fetaj” dhe “ISB - Cakay”. Andaj, e paditura ATK-ja bazuar në raportin e BPB-së me numër të llogarisë ... të datës 29.11.2018, ka vërejtur se tatimpaguesi ka të hyra nga pagesa në bankë, për shitjen e cisternës dhe traktorit. ATK-ja në bazë të analizës së dokumentacionit në dosje dhe verifikimit nga regjioni Pejë, ka konstatuar se shitjen e ka bërë “Fetaj”-paditësi dhe kjo shitje nuk është deklaruar dhe nuk është evidentuar as në librin e shitjeve, prandaj shitja e kamionit–cisternë llogaritet si qarkullim shtesë, pasi që paditësi nuk ka mbajtur evidenca konform nenit 13 të ligjit 03/L-222 për ATK-në dhe nenit 17 të Udhëzimit Administrativ 15/2010. Prandaj në këtë kuptim Gjykata nuk i ka pranuar si të bazuara pretendimet e paditësit për arsye se, paditësi ka dështuar që të provoj saktë me prova materiale argumentet dhe pretendimet e tij në padi, pasi që paditësi në rastin konkret bartë detyrimin e vërtetimit të pretendimeve në padi, ndërsa provat e paraqitura në Gjykatë nuk janë me ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështje administrative.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimin i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje

qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpatria e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për aplikim të gabuar të dispozitave procedurale, këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të paditësit për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që me standardet e kontabilitetit, një mall definohet si i pranuar ne evidencat e kontabilitetit me dokumentacion përcjellës të rregullt siç janë: faturë përcjellëseja, fatura e rregullt, DUD dhe kontratat, e të gjitha këto përbejnë një tërësi në kontabilitet, si mall i pranuar dhe evidentohet ne stoqe, që në rastin konkret nuk ekzistojnë dhe nuk janë përmbushur këto kushte. Këtë pretendim të paditësit kolegji i kësaj gjykate nuk e pranon si të bazuar dhe i njëjti pretendim nuk lidhet me rastin konkret, pasi që kontesti në këtë rast është për shitje të mallit, e dëshmuar përmes transaksionit bankar, e që ka rezultuar me qarkullim shtesë, e jo siç pretendon paditësi në ankesë për pranim- blerje të mallit. Prandaj në mungesë të fakteve që të vërtetohen pretendimet e paditësit, gjykata e shkallës së parë pas administrimit te provave dhe vlerësimit te tyre, me të drejtë ka pranuar konstatimet e dhëna ne vendimin kontestues dhe Raport kontrollit, se vlerësimi i kontrolli është bërë duke u bazuar ne librat dhe regjistrimet e tatimpaguesit te prezantuara nga vete tatimpaguesi, dhe si rezultat i kësaj është konstatuar se paditësi shitje e cisternës dhe traktorit, në vlerë prej 16,500.00€, nuk ka deklaruar dhe nuk është evidentuar as në librin e shitjeve. Andaj ne bazë të nenit 19 parag 2.1 Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 i cili parasheh se: *‘Vlerësimi i Drejtorit të Përgjithshëm do të bëhet sipas gjykimit të tij ose saj më të mirë dhe do të bazohet në të gjitha provat që ai ose ajo ka në dispozicion, përfshirë: 2.1. librat, regjistrimet, kuponët, faturat, ose informatat tjera përkatëse të tatimpaguesit; si dhe ne pajtim me nenin 13 te këtij ligji nenit 17, 18 te UA 15/2010.’* Andaj në kuptimin e drejtë të kësaj dispozite ligjore shihet se e paditura ka bërë vlerësimin tatimor dhe ka ngarkuar me tatim shtese paditësin në bazë të dokumentacionit që ka pasur në dispozicion, dhe provave të deklaruara nga vet tatimpaguesi, andaj, mbi këtë bazë e paditura ka aplikuar drejtë dispozita ligjore te lartcekura të KDA-së kur e ka obliguar paditësin qe të paguaj tatim shtese.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa, e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. .

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së dytë  
K.Dh.Sh.II.nr.1067/22, me datë 22.02.2024

Kryetar i kolegjit, gjyqtari  
Dren Rogova